



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2435 prot.

Gramsh, më 07 / 06 / 2024

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE TË DETYRUAR
PËR PUNONJËS ARSIMORË NË ARSIMIN PARASHKOLLOR**

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018); Udhëzimit nr. 8, datë 03.05. 2024 " Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune si dhe të administrimit të Portalit “Mësues për Shqipërinë”, shpall procedurat për lëvizje paralele të detyruar për mësuese të arsimit parashkollor, për arsye të rënies së numrit të fëmijëve në kopshte

Afati për dorëzimin e dokumentave

07.06.2024 - 20. 06. 2024

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Diploma e shkolles;
2. Lista e notave;
3. Vërtetim për vjetërsinë në punë;
4. Dëshmi kualifikimi;
5. Dëshmi e gjuhës së huaj;
6. Çertifikata trajnimi;
7. Procesverbali i opinionit të prindërve;

8. Vlerësimi nga punonjësi i shërbimit psikosocial;
9. Vlerësimi nga drejtori i institucionit arsimor;
10. Deklarate për lejimin e vlerësimit të dokumentacionit në dosje ;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë në Zyrën e Protokoll-Arkivit, Bashkia Gramsh, brenda datës 20. 06. 2024.

Shpallja e renditjes së konkurrentëve për lëvizjen paralele të detyrueshme, do të bëhet sipas rendit zbritës, më datë 01.07. 2024;

- Vlerësimi i dosjesve të kandidatëve për lëvizje paralele të detyruar, do të bëhet në periudhën 21 – 30 Qershor 2024;
- Njoftimi do të bëhet në faqen zyrtare të Bashkisë , në stendën e informimit të publikut si dhe me e-mail;
- Afati për ankim është 3 (tre) ditë duke filluar nga data 01.07. 2024.

KRYETARI

Besion AJAZI

